



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 183

Tiranë – E premte, 21 gusht 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Urdhër i Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave nr. 421, datë 18.8.2026	Për delegim kompetencash..... 18365
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 826, datë 13.8.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Spanjës..... 18365
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 827, datë 13.8.2026	Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Francës..... 18367
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 219, datë 10.8.2026	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit, për muajin korrik 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kv..... 18368
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 220, datë 10.8.2026	Mbi licencimin e shoqërisë “Global Interprise Group” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike..... 18370
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 221, datë 10.8.2026	Mbi fillimin e procedurës administrative për kërkesën e shoqërisë “3x Energy” shpk, për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike..... 18372
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 222, datë 10.8.2026	Mbi fillimin e procedurës administrative për kërkesën e shoqërisë “Kronos Konstruksion” shpk për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike..... 18374
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 223, datë 10.8.2026	Mbi licencimin e shoqërisë “Gerti” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike..... 18376
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 224, datë 10.8.2026	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, lidhur me shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Gerti” shpk, për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike..... 18378

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 225, datë 10.8.2026	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, lidhur me kërkesën e shoqërisë “Yildirim Energy Europe Albania” shpk, për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	18380
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 226, datë 10.8.2026	Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, lidhur me kërkesën e shoqërisë “Yildirim Energy Europe Albania” shpk, për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	18381
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 227, datë 10.8.2026	Mbi kërkesën e shoqërisë “Drini Bulqize” shpk për transferimin e plotë të licencës së prodhimit të energjisë elektrike te shoqëria “HEC Polemi” shpk.....	18382
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 228, datë 10.8.2026	Mbi kërkesën e shoqërisë “Drini Bulqizë” shpk për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të HEC “Polemit”, nga shoqëria “Drini Bulqizë” shpk tek shoqëria “HEC Polemi” shpk.....	18384
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 229, datë 10.8.2026	Mbi dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor që kontrollon interesat e shoqërisë “Noa Energy Trade” shpk.....	18387

**URDHËR****Nr. 421, datë 18.8.2026****PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje dhe zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, “Për arkivat”, të ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave z. Endrit Musaj, zëvendës drejtor i përgjithshëm, për shkak të mungesës me arsye të titullarit të këtij institucioni.

2. Delegimin e kompetencave të drejtuesit, lidhur me personelin dhe burimet njerëzore, të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

3. Kompetencat e Drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave do të ushtrohen për periudhën nga data 19.8.2026 deri në datën 21.8.2026.

4. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet zëvendës drejtori i përgjithshëm, z. Endrit Musaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Auron Rrokaj

URDHËR**Nr. 826, datë 13.8.2026****PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË SHFAQUR NË SHTETIN E SPANJËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shtetën e Spanjës, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë*
Aragón	Huesca	Boltaña*
Cataluña	Girona	Pla de l'estany (banyoles)*
Castilla y León	Segovia	Segovia*
Castilla - La Mancha	Toledo	Galvez*
Castilla - La Mancha	Toledo	Toledo*
Castilla - La Mancha	Toledo	Oropesa*
Comunidad Foral de Navarra	Navarra	Ochagavía*
Extremadura	Badajoz	Don Benito*
País Vasco	Gipuzkoa	Gipuzkoa*
Illes Balears	Illes Balears	Palma*
Illes Balears	Illes Balears	Menorca*
Galicia	A Coruña	Ferrol*
Galicia	A Coruña	A Barcala*
Galicia	Lugo	Meira*
La Rioja	La Rioja	Alfaro*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve



Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitropa për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antitropave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitropat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Urdhri nr. 822, datë 12.8.2026, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së gjuhës blu, të shfaqur në shtetin e Spanjës”, shfuqizohet.

9. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i



Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Tana Kika

URDHËR
Nr. 827, datë 13.8.2026

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ
SËMUNDJES SË GJUHËS BLU, TË
SHFAQUR NË SHETËTIN E FRANCËS**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 1, të nenit 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit dhe tranzitimit nga zonat e përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri për në territorin e Republikës së Shqipërisë, të:

a) kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë;

b) spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

2. Zonat e prekura me sëmundjen e gjuhës blu, të shfaqur në shetëtin e Francës, janë sipas ndarjeve administrative të tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit të parë	Ndarja administrative e nivelit të dytë	Ndarja administrative e nivelit të tretë
Ariège*		
Aude*		
Aveyron*		
Cantal*		
Creuse*		
Dordogne*		
Gers*		
Haute-Garonne*		
Hautes-Pyrénées*		
Haute-Savoie*		
Hérault*		
Lot*		
Puy-de-Dôme*		
Pyrénées-Atlantiques*		
Tarn*		

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

3. Importi dhe tranzitimi nga ndarjet administrative të cilat nuk janë të cituara në tabelën e mësipërme, lejohet vetëm nëse plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Certifikata shëndetësore veterinarë vërteton që kafshët e gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e dërgesës; dhe

ii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 60 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës; ose

iii. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 28 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë asaj periudhe i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antitrupe ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, të kryera të paktën 28 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët; ose

iv. kanë qenë të mbrojtur nga sulmet e mushkonjave të gjinisë *culicoides*, në përputhje me nenin 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët për të paktën 14 ditë para dërgesës dhe gjatë transportit në vendin e dërgesës, dhe gjatë kësaj periudhe i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes, me rezultate negative, të kryer të paktën 14 ditë pas futjes në stabilimentin e mbrojtur nga vektorët;

b) janë:

i. vaksinuar, të paktën 60 ditë përpara dërgesës, kundër të gjitha stereotipave të demonstruara të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje, në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ii. identifikuar si të vaksinuar; ose

iii. është demonstruar se kishte antitrupe për të paktën 60 ditë përpara dërgesës kundër të gjitha stereotipave të demonstruara se janë të pranishme në popullatën burimore nëpërmjet një programi mbikëqyrjeje në përputhje me nenet 8.3.14 deri në 8.3.17 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;



c) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që meshkujt dhurues të spermës së kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë para fillimit dhe gjatë mbledhjes së spermës; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për zbulimin e antittrupave ndaj virusit të gjuhës blu, me rezultate negative, midis 28 dhe 60 ditësh pas çdo grumbullimi për këtë ngarkesë; ose

iv. i janë nënshtruar një testi identifikimi të agjentit të sëmundjes në mostrat e gjakut të mbledhura në fillim dhe përfundim të, dhe të paktën çdo 7 ditë (testi i izolimit të virusit) ose të paktën çdo 28 ditë (testi PCR) gjatë mbledhjes së spermës për këtë ngarkesë, me rezultate negative;

v. sperma është mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.6 dhe 4.7 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore;

ç) Certifikata shëndetësore veterinare vërteton që femrat dhuruese të embrioneve *in vivo* të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë:

i. nuk kanë treguar asnjë shenjë klinike të gjuhës blu në ditën e mbledhjes; dhe

ii. janë mbajtur në një stabiliment të mbrojtur nga vektorët, në përputhje me pikën 1, të nenit 8.3.13 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, për të paktën 60 ditë përpara fillimit dhe gjatë mbledhjes së embrioneve; ose

iii. i janë nënshtruar një testi serologjik për të zbuluar antittrupat ndaj virusit të gjuhës blu midis 28 dhe 60 ditësh pas grumbullimit, me rezultate negative; ose

iv. i janë nënshtruar një testi për identifikimin e agjentit të sëmundjes në një kampion gjaku të marrë në ditën e mbledhjes së embrioneve, me rezultate negative;

v. embrionet janë mbledhur, përpunuar dhe ruajtur në përputhje me kapitujt 4.8, 4.9 dhe 4.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore, sipas rastit;

vi. sperma e përdorur për fekondimin e ovociteve ishte në përputhje me nenin 8.3.9 ose nenin 8.3.10 të Kodit Shëndetësor të Kafshëve Tokësore.

4. Certifikata veterinare shëndetësore garanton origjinën e tyre sipas përcaktimeve në pikat 2 dhe 3 të këtij urdhri.

5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve informojnë të gjithë subjektet importuese të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

6. Ky urdhër nuk zbatohet për ngarkesat e certifikuara para datës së hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

7. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit informon rregullisht brenda 24 orëve Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit për çdo ngarkesë të të gjitha kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë, spermës dhe embrioneve të kafshëve të gjalla të llojit ruminantë dhe kamelidë.

8. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Tana Kika

VENDIM
Nr. 219, datë 10.8.2026

**MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË
SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË
FUNDIT, PËR MUAJIN KORRIK 2026,
PËR KLIENTËT E LIDHUR NË
NIVELIN E TENSIONIT 35 kV**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 110, pika 4, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, miratuar me vendimin e



Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar me vendimin nr. 144, datë 25.6.2018 dhe nr. 233, datë 20.12.2019; dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.8.2026, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 2384/1 prot., datë 7.8.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin korrik 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV”,

Konstatoi se:

I. Aspektet ligjore dhe procedurale

1. Paraqitja e kërkesës nga “FSHU” sh.a.

Shoqëria “FSHU” sh.a. me shkresën nr. 4784 prot., datë 3.8.2026, protokolluar në ERE me nr. 2384 prot., datë 3.8.2026, ka depozituar kërkesën mbi miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për muajin korrik 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit.

2. Procesi i shqyrtimit të dokumentacionit nga ERE

Kërkesa është shqyrtuar në përputhje me nenin 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe në mbështetje të neneve 16 dhe 110, pika 4, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe “Metodologjisë për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, të ndryshuar.

II. Analiza e përlogaritjes së çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin korrik 2026, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV

1. Blerja e energjisë në bursë

Për muajin korrik 2026, “FSHU” sh.a. ka siguruar sasinë e nevojshme të energjisë elektrike për këtë kategori klientësh përmes blerjeve ditore/mujore në Bursën Shqiptare të Energjisë (ALPEX), duke u bazuar në profilet ditore të prokurara, çmimet ditore/orare dhe vlerat përkatëse të faturuara.

2. Përlogaritja e Çmimit Mesatar të Ponderuar të Blerjes (ÇBEt)

Bazuar në të dhënat e paraqitura, “FSHU” sh.a. ka përlogaritur çmimin mesatar të ponderuar të blerjes së energjisë elektrike për muajin korrik 2026 në vlerën 11.32 lekë/kWh. Kjo vlerë është verifikuar edhe nga ERE, nëpërmjet një rillogaritjeje, nga e cila rezultoi se mesatarja e ponderuar e çmimit të blerjes së energjisë elektrike është 11.32 lekë/kWh, në përputhje me përlogaritjet e paraqitura nga shoqëria.

3. Komponentët sipas metodologjisë (neni 8, i vendimit nr. 201, datë 4.12.2017, i ndryshuar)

Në përputhje me metodologjinë përkatëse, komponentët e përdorur për përlogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike janë si më poshtë:

- Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike (ÇBEt) për muajin korrik 2026: 11.32 lekë/kWh;

- Tarifa e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 1 janar 2025 – 31 dhjetor 2027, e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 279, datë 16.12.2024: 0.85 lekë/kWh;

- Tarifa e shërbimit të shpërndarjes në nivel tensioni 35 kV, sipas vendimit të Bordit të ERE-s nr. 312, datë 12.12.2025, “Mbi lënie në fuqi deri më 30 prill 2026 të tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike” të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 73, datë 13.4.2022: 1.55 lekë/kWh;

- Kostot administrative: 1.06 lekë/kWh;

- Kurset zyrtare të këmbimit të publikuara nga Banka e Shqipërisë (lekë/euro), për çdo datë respektive në harkun kohor 30.6.2026 – 30.7.2026.

- Në zbatim të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, referuar aplikimit të “FSHU” sh.a., si dhe mbështetur në llogaritjet e ERE-s, çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin korrik 2026, përlogaritet si më poshtë:

Çmimi i energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV për muajin korrik 2026			
		Njësia	Çmimi
CBEt	Çmimi mesatar i ponderuar i blerjes së energjisë elektrike	Lekë/kWh	11.32
Pr	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	Lekë/kWh	0.34
CA	Kosto administrative të Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kWh	1.06
TRr	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kWh	0.85
TSHt	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kWh	1.55
Çmimi i energjisë = CBEt + Pr * CBEt + TRr + TSHt + CA			Lekë/kWh 15.12



- Bazuar në çdo element të formulës llogaritëse, si dhe duke marrë në konsideratë të dhënat e paraqitura në aplikimin e shoqërisë, rezulton se:

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit rezulton 15.12 lekë/kwh për muajin korrik 2026.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin korrik 2026 prej 15.12 lekë/kwh, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

2. Ndryshimi i secilit element përbërës në llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për kategorinë e klientëve të cilësuar në këtë vendim, do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga Bordi i ERE-s.

3. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 220, datë 10.8.2026

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “GLOBAL INTERPRISE GROUP” SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 40, pika 2, germa “a”, 41, pika 1, germa “a”, dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të

neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.8.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1722/10 prot., datë 5.8.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Global Interprise Group’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Global Interprise Group” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1722 prot., datë 1.6.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Doma”, me kapacitet të instaluar 1.695 mw, me vendndodhje në përroin e Lusës, degë e Lumit Mat, Bashkia Klos, qarku Dibër.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 168, datë 15.6.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 16.6.2026 dhe 17.6.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 25.6.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, po ashtu, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure, nëpërmjet shkresës nr. 1722/4 prot., datë 18.6.2026, ku i ka kërkuar të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe, në lidhje me vlefshmërinë e kontratës dhe të drejtën e shoqërisë për ndërtimin dhe shfrytëzimin e këtij burimi gjenerues. Nga ana e MIE-s nuk ka pasur ndonjë qëndrim, në lidhje me fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë.

- Me shkresën nr. 1722/3 prot., datë 18.6.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës, si dhe i ka bërë me dije, në lidhje me informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në aplikim.



- Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1722/5 prot., datë 29.6.2026, ka depozituar informacion/dokumentacion plotësues. Nga shqyrtimi i tij rezultoi se ishte i nevojshëm plotësimi i mëtejshëm i dokumentacionit, në lidhje me mbështetjen financiare, ndaj ERE iu drejtua shoqërisë me *email*-in me nr. 1722/6 prot., datë 9.7.2026.

- Si e tillë, me qëllimin për t'i lënë kohë shoqërisë të depozitojë dokumentacionin e munguar, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 192, datë 13.7.2026, vendosi të zgjasë afatin e vendimarrjes me 30 ditë.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1722/9 prot., datë 23.7.2026, shoqëria ka depozituar dokumentacionin e kërkuar.

- Nga dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria për qëllime të këtij aplikimi, rezulton se është depozituar korrespondencë me institucione të ndryshme shtetërore, lidhur me pengesat e hasura për zhvillimin e projektit në terren, si dhe dokumentacion gjyqësor nga i cili rezulton se shoqëria është palë në një proces gjyqësor me banorë të zonës, të cilët kanë kërkuar, pavlefshmërinë e disa akteve administrative, si dhe sigurimin e padisë, duke kërkuar pezullimin e punimeve deri në përfundimin e procesit gjyqësor. Për këtë, shoqëria ka depozituar vendimin e formës së prerë të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, datë 16.10.2025, me anë të të cilit është refuzuar kërkesa e banorëve për sigurimin e padisë.

- Për rrjedhojë, vlerësohet se procesi gjyqësor në zhvillim nuk përbën, në vetvete, një rrethanë ligjore që pengon vijimin e procedurës administrative apo marrjen e një vendimi mbi kërkesën për licencim, për sa kohë nuk ekziston një vendim gjyqësor që të ketë pezulluar zbatimin e akteve përkatëse ose të ketë vendosur kufizime mbi ushtrimin e kompetencës së autoritetit administrativ. Megjithatë, duke mbajtur në konsideratë faktin se rezultati i këtij procesi mund të ketë ndikim mbi rrethanat faktike ose juridike mbi të cilat mbështetet kjo vendimarrje, vlerësohet e arsyeshme që në vendimin e licencimit të parashikohet se ai do t'i nënshtrohet rishikimit në rast se depozitohet një vendim gjyqësor i formës së prerë, përmbajtja e të cilit afekton këtë vendimarrje.

- Nga analizimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për procedurat dhe afatet

për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera:

Rezulton se shoqëria “Global Interprise Group” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 642 rep., nr. 1977 kol., datë 27.12.2018, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit ‘Doma’ me kapacitet prodhues 1.695 mw, në përroin e Lusës, degë e Lumit Mat, Bashkia Klos, qarku Dibër”;

- Është pajisur me miratimin e pikës së lidhjes së HEC-it me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së OSHEE-së sha nr. nr. 1491/2 prot., datë 25.7.2018, për kapacitetin 1695 kw;

- Është pajisur me lejen për përdorim burimi uJOR sipërfaqësor nr. 40 prot., datë 26.12.2023, lëshuar nga Këshilli i Basenit UJOR (KBU) Mat, me afat vlefshmërie deri më 26.12.2028.

- Është pajisur me VNM paraprake, lëshuar më 7.9.2023 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit “Ndërtim HEC ‘Doma’”, me kapacitet të instaluar 1695 kw.

Kushtet dhe afatet ligjore:

- Shoqëria ka parashikuar se do të fillojë operimin e centralit në shkurt 2027. Në referencë të përcaktimeve të nenit 9, pika 2 të kontratës së nënshkruar me MIE-n, koncesionari merr përsipër të vërë në punë hidrocentralin brenda 24 (njëzetekatër) muajve nga data e marrjes së të gjitha lejeve për fillimin e punimeve dhe rezulton se shoqëria është pajisur me lejen e ndërtimit në datën 23.1.2025. Si e tillë, vlerësohet që në vendim të përcaktohet se ajo duhet të fillojë operimin brenda këtyre afateve, pra brenda datës 23.1.2027.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 10, të kontratës nr. 642 rep., nr. 1977 kol., datë 27.12.2018, ku parashikohet procedura e testimit të veprës, vlerësohet që t'i lihet detyrë shoqërisë që, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga fillimi i ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për testimin dhe vënien në punë të veprës.

- Shoqëria aktualisht ka një leje uji të vlefshme (deri në datën 26.12.2028), por duke qenë se ky afat nuk mbulon të gjithë periudhën e vlefshmërisë së licencës, vlerësohet që të përcaktohet që shoqëria



duhet të depozitojë lejen e ujit të përditësuar brenda datës 26.12.2028.

- ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi në rast të depozitimit të sa lënë detyrë shoqërisë dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.

- Në përfundim, vlerësohet se shoqëria ka përmbushur kushtet për licencim, me detyrimin për të respektuar afatet dhe detyrimet e përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë e shoqërinë “Global Interprise Group” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Doma”, me kapacitet të instaluar 1.695 mw, me vendndodhje në përroin e Lusës, degë e Lumit Mat, Bashkia Klos, qarku Dibër, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 23.1.2027.

3. Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga fillimi i operimit, shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës.

4. Shoqëria duhet të depozitojë në ERE lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujqor brenda datës 26.12.2028.

5. Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të pikave 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi, në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi, si dhe në rast të depozitimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë që afekton këtë vendimarrje.

6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Global Interprise Group” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), “OSSH” sh.a., “FTL” sh.a. dhe ALPEX sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të

bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 221, datë 10.8.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR KËRKESËN E SHOQËRISË “3X ENERGY” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 40, pika 2, germa “a”, 41, pika 1, germa “a” dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.8.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2239/1 prot., datë 5.8.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘3X Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “3X Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2239 prot., datë 27.7.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiq “3X Energy Sol Park”, me kapacitet të instaluar 70 mw dhe veprat ndihmëse, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3268, fshati Saver, Njësia Administrative Lushnjë, Bashkia Lushnjë, qarku Fier.

- Në këtë aplikim shoqëria ka kërkuar, gjithashtu, përfshirjen e veprave ndihmëse (sistemet e



akumulimit), duke sqaruar se ato nuk synojnë rritjen e kapacitetit të prodhimit apo injektimit në rrjet, por optimizimin e operimit të centralit fotovoltaiik.

- Referuar nenit 51, pika 3, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikimet për njohjen e impianteve të depozitimit të energjisë lidhen me impiantet që janë në zhvillim ose në operim pa licencë për depozitimin e energjisë në datën e hyrjes në fuqi të ligjit, sipas licencës ekzistuese.

- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.7.2026, ka bërë me dije se çdo ndryshim në projekt, përfshirë shtimin e veprave ndihmëse apo njërive të depozitimit të energjisë elektrike, duhet të trajtohet në përputhje me kushtet kontraktuale dhe kuadrin rregullator në fuqi.

- Për sa i përket sistemeve të akumulimit të energjisë elektrike të parashikuara nga shoqëria si vepra ndihmëse të centralit fotovoltaiik, Bordi vlerëson se kjo pjesë e kërkesës nuk mund të konsiderohet e përfshirë në objektin e kësaj procedure për licencimin në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për sa kohë që shoqëria nuk disponon një licencë dhe çështja e trajtimit të këtyre impianteve, në raport me dispozitat e ligjit nr. 59/2026, kushtet kontraktuale të projektit dhe aktet administrative përkatëse, është objekt i sqarimit institucional. Për rrjedhojë, sistemet e akumulimit të energjisë elektrike, të paraqitura nga shoqëria “3X Energy” sh.p.k., si vepra ndihmëse të centralit fotovoltaiik, nuk përfshihen në objektin e licencimit të filluar me këtë vendim. Trajtimi i tyre do të bëhet në vijim, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, në konsideratë të qëndrimit institucional të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pikat 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave “a”, “b” dhe “c”, duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave “a”, “c” dhe “d”.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germave “a” dhe “c”.

- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas germave “a”, “b”, “d”, “e” dhe “f”.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

Shoqëria “3X Energy” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me MIE-n kontratën nr. 2723 rep., nr. 904 kol., në datën 8.6.2026, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaiike, me kapacitet prodhues 70 mw dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3268, fshati Saver, Njësia Administrative Lushnjë, Bashkia Lushnjë, qarku Fier, nga shoqëria ‘3X Energy’ sh.p.k.”;

- Ka marrë miratimin paraprak për pikën e lidhjes së centralit me rrjetin e transmetimit nëpërmjet shkresës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a. nr. 1804/1 prot., datë 11.3.2026;

- Është pajisur me VNM paraprake nr. AN140320260019, datë 2.4.2026, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit “3X Energy Sol Park me kapacitet të instaluar 70 mw dhe veprat ndihmëse (blloku 1 i projektit).”; VNM paraprake nr. AN010420260251, datë 10.4.2026, për zhvillimin e projektit “Ndërtimi i centralit fotovoltaiik ‘3x Energy Sol Park’ me kapacitet të instaluar 70 mw dhe veprat ndihmëse (blloku 2 i projektit).”, dhe VNM paraprake nr. AN020420260020, datë 10.4.2026 për zhvillimin e projektit “Ndërtimi i centralit fotovoltaiik ‘3x Energy Sol Park’ me kapacitet të instaluar 70 mw dhe veprat ndihmëse (blloku 3 i projektit).”. shoqëria ka depozituar tre VNM paraprake, pasi rezulton se projekti i centralit fotovoltaiik shtrihet në tre blloqe të ndryshme në zonën kadastrale nr. 3268. Dokumentacioni mjedisor i sipërpërmendur do të vlerësohet në vijim të procedurës së licencimit në raport me objektin, kapacitetin dhe konfigurimin përfundimtar të projektit të paraqitur për licencim.

- Rezulton se shoqëria duhet të plotësojë këtë aplikim dhe me dokumentacionin si vijon:



Neni 9. Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1. Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “b”: Të depozitojë dëshmitë e penalitetit të përditësuar, pasi janë depozituar jashtë afatit të përcaktuar në nenin 8, pika 3, të rregullores.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- germa “b”: Informacion mbi modalitetin e parashikuar për shlyerjen e plotë të vlerës së kontratës së sipërmarrjes, si dhe të dokumentojë investimet e kryera deri në këtë fazë prej saj në kuadër të projektit, në lidhje me pjesën e mbetur të 20% të vlerës së investimit.

Pika 2. Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1: Për t'u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- germa “c”: Të sqarojë/saktësojë kapacitetin e instaluar të centralit, i cili do të pasqyrohet dhe në miratimin përfundimtar të pikës së lidhjes/marrëveshjes respektive, që duhet të depozitohet në ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën administrative për licencimin e shoqërisë “3X Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 70 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3268, fshati Saver, Njësia Administrative Lushnjë, Bashkia Lushnjë, qarku Fier.

2. Shoqëria “3X Energy” sh.p.k. të depozitojë në ERE dokumentacionin dhe sqarimet përkatëse të kërkuara gjatë shqyrtimit të aplikimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “3X Energy” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data

e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 222, datë 10.8.2026

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR KËRKESËN E SHOQËRISË “KRONOS KONSTRUKSION” SHPK PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 40, pika 2, germa “a”, 41, pika 1, germa “a” dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.8.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2233/1 prot., datë 5.8.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Kronos Konstruktion’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

-Shoqëria “Kronos Konstruktion” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2233 prot., datë 27.7.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar



50 mw, me vendndodhje në afërsi të fshatit Vërnik, Njësia Administrative Qendër Bilisht, Bashkia Devoll, qarku Korçë.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se:

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

-Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave “a”, “b” dhe “c”, duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1.

-Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave “a”, “b”, “c” dhe “d”.

-Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germave “a” dhe “c”.

-Në përputhje me nenin 9, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas germave “b”, “d” dhe “f”.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

Shoqëria “Kronos Konstruktion” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) në datën 15.6.2026, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 50 mw dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në afërsi të fshatit Vërnik, Njësia Administrative Qendër Bilisht, Bashkia Devoll, qarku Korçë, nga shoqëria ‘Kronos Konstruktion’ sh.p.k.”;

- Ka marrë miratimin paraprak për pikën e lidhjes së centralit me rrjetin e transmetimit nëpërmjet shkresës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.) nr. 1453/2 prot., datë 18.3.2025;

-Është pajisur me VNM paraprake nr. AN150420250019, datë 5.6.2025, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit “Park fotovoltaike 50 mw”, dhe VNM paraprake nr. AN150420250015, datë 5.6.2025 për zhvillimin e projektit “Parku fotovoltaike dhe rrjet kabllor ajror”, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM).

- Rezulton se shoqëria duhet të plotësojë këtë aplikim dhe me dokumentacionin, si vijon:

Neni 9. Formatit dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- germa “b”: depozitohet dokumentacionin e mbështetjes financiare për realizimin e investimit, sipas modalitetit të parashikuar në planin e biznesit.

Pika 2. Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

2.1: Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitohet gjithashtu:

- germa “a”: depozitohet garanci për panelet që do të përdorë, në rast se ka, në mënyrë që të rakordohet dhe vlefshmëria e licencës, si dhe të përcaktojë një datë konkrete për fillimin e operimit;

- germa “c”: të sqarojë/saktësojë kapacitetin e instaluar të centralit, i cili do të pasqyrohet dhe në miratimin përfundimtar të pikës së lidhjes/marrëveshjes respektive, që duhet të depozitohet në ERE;

- germa “e”: të japë informacion në rast se kanë filluar punimet për ndërtimin e tij.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1.Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Kronos Konstruktion” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 50 mw, me vendndodhje në afërsi të fshatit Vërnik, Njësia Administrative Qendër Bilisht, Bashkia Devoll, qarku Korçë.

2.Shoqëria “Kronos Konstruktion” sh.p.k. të depozitohet në ERE dokumentacionin dhe sqarimet përkatëse të kërkuara gjatë shqyrtimit të aplikimit, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës, të njoftojë shoqërinë “Kronos Konstruktion” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data



e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti

VENDIM
Nr. 223, datë 10.8.2026

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“GERTI” SHPK NË VEPRIMTARINË
E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 40, pika 2, germa “a” dhe 41, pika 1, germa “a”, dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.8.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2015/16 prot., datë 7.8.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Gerti’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Gerti” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2015 prot., datë 2.7.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltai, me kapacitet të instaluar 10 mw, me vendndodhje në Vlashaj, Njësia Administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër, duke përfshirë dhe veprat ndihmëse/njësitë

e depozitimit të energjisë elektrike, si vepra ndihmëse, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit.

- Në vijim të këtij aplikimi, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 193, datë 13.7.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 15.7.2026 dhe 16.7.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 27.7.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE me shkresën nr. 2015/6 prot., datë 17.7.2026, ka njoftuar Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. për fillimin e procedurës, ndërsa me shkresën nr. 2015/7 prot., datë 17.7.2026, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Nga ana e tyre nuk ka rezultuar të jetë depozituar ndonjë përgjigje.

- Me shkresën nr. 2015/5 prot., datë 17.7.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitimin e dokumentacionit/informacionit të munguar.

- Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2015/10 prot., datë 22.7.2026, shoqëria ka depozituar informacionin/dokumentacion plotësues për aplikimin, ku ka kërkuar dhe përsheptimin e shqyrtimit dhe përfundimit të procedurës, brenda mundësive dhe afateve ligjore të parashikuara, duke marrë në konsideratë rëndësinë e realizimit të investimit dhe angazhimet financiare të shoqërisë. Për sa shqyrtuar dhe duke qenë se kishte ende dokumentacion që nevojitej të plotësohej, në lidhje me mbështetjen financiare, ERE iu drejtua shoqërisë me *email*-in nr. 2015/11 prot., datë 24.7.2026, duke i bërë me dije se përpara shqyrtimit të çdo kërkesë të saj, duhet të depozitohet dokumentacioni i kërkuar.

- Me *email*-in e datës 6.8.2026, shoqëria ka sjellë dokumentacion të përditësuar, në lidhje me mbështetjen financiare. Me *email*-in e të njëjtës ditë, ERE i ka kërkuar shoqërisë që të depozitojë këtë dokument në formatin original ose fotokopje të njësuar me origjinalin dhe të bëjë me dije në rast se ka ndonjë qëndrim nga MIE, në lidhje me veprat ndihmëse. Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2015/14 prot., datë 7.8.2026, ka depozituar dokumentacionin financiar në format origjinal.



- Në lidhje me kërkesën e shoqërisë për përfshirjen në licencë të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike (2 x 5 mw), të deklaruara si vepra ndihmëse, nga korrespondenca e zhvilluar me MIE-n, kjo e fundit është shprehur se çdo ndryshim në projekt, përfshirë shtimin e veprave ndihmëse, duhet të trajtohet në përputhje me kushtet kontraktuale dhe kuadrin rregullator në fuqi. Gjithashtu, për disa raste të tjera, MIE ka sqaruar se rregullat për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese përcaktohen nga VKM-ja nr. 822, datë 7.10.2015, e ndryshuar, ndërsa neni 51 i ligjit nr. 59/2026, parashikon regjimin kalimtar për impiantet e depozitimit të energjisë elektrike. Po ashtu, ERE i është drejtuar MIE-s për marrjen e një qëndrimi institucional, duke qenë se trajtimi i veprave të depozitimit të energjisë elektrike kërkon një vlerësim të harmonizuar ndërmjet dispozitave të ligjit nr. 59/2026, kushteve kontraktuale dhe akteve administrative që kanë mundësuar zhvillimin e projektit.

- Në këto kushte, vlerësohet se kërkesa e shoqërisë për përfshirjen në licencë të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike (2 x 5 mw), të deklaruara si vepra ndihmëse, nuk përfshihet në objektin e kësaj licence dhe trajtimi i tyre do të bëhet në vijim, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe me procedurën përkatëse të përcaktuar nga ERE.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pika 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas germave “a”, “b” dhe “c”, duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në shtojcën 1.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas germave “a”, “b”, “c” dhe “d”.

- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas germave “a”, “b” dhe “c”.

- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas germave “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

- Shoqëria “Gerti” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me MIE-n kontratën nr. 1232 rep., nr. 581 kol., datë 10.2.2026 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 10 mw dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Vlashaj, Njësia administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër, nga shoqëria ‘Gerti’ sh.p.k.”;

- Ka marrë miratimin për pikën e lidhjes së centralit me rrjetin e shpërndarjes nëpërmjet shkresës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. nr. 3502/3 prot., të datës 17.4.2024, me lëndë “Miratim pikë lidhje për central fotovoltaike”,

- Është pajisur me VNM paraprake, nr. AN110220260055, Komisioni nr. 26, lëshuar më 18.03.2026, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit “Ndërtimi i Parkut Fotovoltaike Murati, 10 mw” dhënë shoqërisë “Gerti” sh.p.k me vendndodhje Vlashaj, Bashkia Bulqizë.

Kushtet dhe afatet ligjore:

- ERE, në zbatim të nenit 41, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”, dhe nenit 5, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet dhe shoqëria ka depozituar garanci deri në 30 vjet për panelet që parashikon përdorë (certifikatën e jetëgjatësisë dhe performancës së paneleve, me prodhues AESOLAR, moduli AE CME-132BDS, ku garancia e produktit/performancës rezulton 30 vjet), ndaj vlerësohet se dhe afati i licencës së ERE-s do të jetë për 30 vjet.

- Shoqëria ka parashikuar që të fillojë operimin brenda datës 31.7.2027, pra brenda afatit të parashikuar në VKM-në nr. 22, datë 21.1.2026, “Për miratimin e ndërtimit, shfrytëzimit dhe administrimit të centralit gjenerues të energjisë



elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Vlashaj, Njësia administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër, nga shoqëria “Gerti” sh.p.k. dhe kontratën me MIE-n nr. 1232 rep., nr. 581 kol., datë 10.2.2026, sipas të cilave centrali duhet të vendoset në punë brenda datës 22.1.2029. Në këto kushte, duke marrë në konsideratë afatin e deklaruar nga shoqëria dhe angazhimin e saj për përfundimin e investimit, vlerësohet që data 31.7.2027 të përcaktohet si afat për fillimin e ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike dhe pasqyrohet si kusht në vendimin e licencimit, pa cenuar afatin dhe detyrimet e përcaktuara në kontratën e lidhur me MIE-n.

- Shoqëria është pajisur me VNM paraprake, datë 18.3.2026, ku për sa i përket afatit të vlefshmërisë, në këtë dokument përcaktohet se projekti duhet të filloj zbatimin në terren brenda 2 (dy) vjetëve, (brenda datës 18.3.2028) dhe ka bërë me dije se nuk i ka filluar ende punimet. Në këto rrethana vlerësohet që t’i lihet asaj kushti për të raportuar në ERE fillimin e tyre deri 3 (tre) muaj përpara datës së parashikuar të fillimit të ushtrimit të veprimtarisë (31.7.2027), pra brenda datës 30.4.2027.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 10 të kontratës nr. 1232 rep., nr. 581 kol., datë 10.2.2026, të nënshkruar me MIE-n, vlerësohet t’i lihet kusht shoqërisë që, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga fillimi i operimit/ushtimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për testimin e veprës.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Gerti” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 10 mw, me vendndodhje në Vlashaj, Njësia Administrative Shupenzë, Bashkia Bulqizë, qarku Dibër, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria duhet të njoftojë në ERE për fillimin e punimeve të centralit brenda datës 30.4.2027.

3. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 31.7.2027.

4. Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga fillimi i ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë

elektrike, shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin që provon kryerjen e testimit të veprës, në përputhje me përcaktimet e kontratës.

5. Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të pikave 2, 3 dhe 4 të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit apo dokumentacionit të ndryshëm nga ai mbi bazën e të cilit është marrë vendimi.

6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “Gerti” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), OSSH sh.a., FTL sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM Nr. 224, datë 10.8.2026

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s, LIDHUR ME SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “GERTI” SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016; Bordi i ERE-



s, në mbledhjen e tij të datës 10.8.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2015/15 prot., datë 7.8.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Gerti’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Gerti” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2015 prot., datë 2.7.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të këtij aplikimi, Bordi i ERE-s me vendimin nr. 194, datë 13.7.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 15.7.2026 dhe 16.7.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 27.7.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Me shkresën nr. 2015/9 prot., datë 20.7.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e fillimit të procedurës dhe i ka kërkuar depozitim të dokumentacionit/informacionit të munguar të aplikimit. Në përgjigje, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2015/10 prot., datë 22.7.2026, shoqëria ka depozituar një pjesë të dokumentacionit, ndaj me *email*-in e datës 6.8.2026, ERE i ka kujtuar shoqërisë të depozitojë planin e biznesit dhe dokumentacionin mbështetës financiar për ushtrimin e veprimtarisë.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2015/14 prot., datë 7.8.2026, shoqëria ka depozituar sërish planin e biznesit për ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, veprimtari për të cilën ka aplikuar paralelisht në ERE. Ky dokument nuk plotëson kërkesat për planin e biznesit për veprimtarinë për të cilën kërkohet licencimi, ndaj shoqëria duhet të depozitojë planin e dedikuar të biznesit për tregtimin, si dhe dokumentacionin përkatës për mbështetjen financiare.

- Në nenin 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, parashikohet:

“Bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë kur dokumentacioni nuk është i plotë, por jo më shumë se 30 ditë.”.

- Për sa më sipër dhe me qëllim për të zhvilluar korrespondencën dhe sqarimet përkatëse me shoqërinë dhe për t'i dhënë kohë asaj për të plotësuar dokumentacionin e munguar, vlerësohet të zgjatet deri në 30 (tridhjetë) ditë afati i vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Gerti” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Shoqëria të depozitojë dokumentacionin e munguar brenda 20 (njëzet) ditëve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Gerti” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Shoqëria “Gerti” sh.p.k. të depozitojë në ERE, brenda 20 (njëzet) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, planin e biznesit të dedikuar për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike dhe dokumentacionin mbështetës financiar për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Gerti” sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

**VENDIM****Nr. 225, datë 10.8.2026**

**MBI ZGJATJEN E AFATIT TË
VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s,
LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË
“YILDIRIM ENERGY EUROPE
ALBANIA” SHPK, PËR RINOVIMIN E
LICENCËS NË VEPRIMTARINË E
FURNIZIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.8.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1923/9 prot., datë 7.8.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Yildirim Energy Europe Albania’ sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike në datën 22.6.2026, brenda afatit të përcaktuar në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike.”.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 186, datë 6.7.2026, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 7.7.2026 dhe 8.7.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 16.7.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Gjatë shqyrtimit të aplikimit, me shkresën nr. 1923/3 prot., datë 15.7.2026, ERE i ka kërkuar shoqërisë plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm. Shoqëria ka depozituar një pjesë të dokumentacionit të kërkuar, por nga verifikimi rezultoi se aplikimi nuk është ende i plotë.

- Konkretisht, mbetet të dokumentohet në mënyrë të plotë disponueshmëria e mbështetjes financiare për ushtrimin e veprimtarisë, si dhe të depozitohen në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin prokura e posaçme dhe vendimi i ortakut të vetëm. Pavarësisht njoftimit të dërguar nga ERE për plotësimin e këtyre mangësive, nuk rezultoi të jetë depozituar dokumentacioni i kërkuar.

- Në këto kushte, duke qenë se dokumentacioni i munguar është i nevojshëm për vlerësimin përfundimtar të kërkesës dhe në përputhje me nenin 14, pika 3, të rregullores, vlerësohet e arsyeshme zgjatja deri në 30 (tridhjetë) ditë e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, duke i lënë shoqërisë një afat prej 20 (njëzet) ditësh për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Shoqëria të depozitojë në ERE brenda 20 (njëzet) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi dokumentacionin e munguar të përcaktuar në këtë vendim.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës, të njoftojë shoqërinë “Yildirim Energy Europe Albania” sh.p.k., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Petrit Ahmeti**



VENDIM
Nr. 226, datë 10.8.2026

MBI ZGJATJEN E AFATIT TË
VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s,
LIDHUR ME KËRKESËN E SHOQËRISË
“YILDIRIM ENERGY EUROPE
ALBANIA” SHPK, PËR RINOVIMIN E
LICENCËS NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 14, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.8.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1922/5 prot., datë 7.8.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Yldirim Energy Europe Albania’ sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”

konstatoi se:

- Shoqëria “Yldirim Energy Europe Albania” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 1922 prot., në datën 22.6.2026, brenda afatit të përcaktuar në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 187, datë 6.7.2026, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 7.7.2026 dhe 8.7.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 16.7.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Gjatë shqyrtimit të aplikimit, me shkresën nr. 1923/3 prot., datë 15.7.2026, ERE i ka kërkuar shoqërisë plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm. Shoqëria ka depozituar një pjesë të dokumentacionit të kërkuar, por nga verifikimi rezultoi se aplikimi nuk është ende i plotë.

- Konkretisht, mbetet të dokumentohet në mënyrë të plotë disponueshmëria e mbështetjes financiare për ushtrimin e veprimtarisë, si dhe të depozitohen në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin Prokura e posaçme dhe vendimi i ortakut të vetëm. Pavarësisht njoftimit të dërguar nga ERE për plotësimin e këtyre mangësive, nuk rezultoi të jetë depozituar dokumentacioni i kërkuar.

- Në këto kushte, duke qenë se dokumentacioni i munguar është i nevojshëm për vlerësimin përfundimtar të kërkesës dhe në përputhje me nenin 14, pika 3, të rregullores, vlerësohet e arsyeshme zgjatja deri në 30 (tridhjetë) ditë e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s, duke i lënë shoqërisë një afat prej 20 (njëzet) ditësh për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit, në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Yldirim Energy Europe Albania” sh.p.k. për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Shoqëria të depozitojë në ERE brenda 20 (njëzet) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi dokumentacionin e munguar të përcaktuar në këtë vendim.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës, të njoftojë shoqërinë “Yldirim Energy Europe Albania” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti



VENDIM

Nr. 227, datë 10.8.2026

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “DRINI BULQIZE” SHPK PËR TRANSFERIMIN E PLOTË TË LICENCËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TE SHOQËRIA “HEC POLEMI” SHPK

Në mbështetje të neneve 16, 46, pika 1 dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; të nenit 17, pikat 2, 3 dhe 5, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.08.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1005/22 prot., datë 6.8.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Drini Bulqize’ sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së prodhimit të energjisë elektrike tek shoqëria ‘HEC Polemi’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Drini Bulqize” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 577, seria P24, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 29.4.2024, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1.751 mw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës mbi tre degëzimet e përroit të Neshtës, degë e Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan, për një afat 30-vjeçar.

- Në vijim të aplikimit të depozituar nga ana e saj me shkresën nr. 1005 prot., datë 30.3.2026, dhe dokumentacionit plotësues të përcjellë me shkresën nr. 1005/1 prot., datë 7.4.2026, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 117, datë 24.4.2026, vendosi fillimin e procedurës për transferimin e plotë të licencës te shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.

- Me shkresën nr. 1005/4 prot., datë 7.5.2026, ERE ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për vendimmarrjen si më sipër, duke i kërkuar asaj që të bëjë me dije nëse nga ana e

saj ka një qëndrim ndryshe në lidhje me transferimin e licencës.

- Me shkresën nr. 1005/7 prot., datë 28.5.2026, MIE njoftoi se kërkesa e shoqërisë për miratimin e ristrukturimit organizativ apo transferimin e aktivitetit ishte ende në fazë shqyrtimi nga ana e saj. Me shkresën nr. 1005/9 prot., datë 4.6.2026, ERE i kërkoj MIE-s depozitimin e qëndrimit përfundimtar.

- Nga korrespondenca e zhvilluar me shoqërinë, rezultoi se kishte ende dokumentacion që nevojitet të plotësohej nga aplikimi, ndaj ERE vlerësoi t’i drejtohej shoqërisë me shkresën nr. 1005/10 prot., datë 4.6.2026.

- Për sa më sipër dhe me qëllim marrjen e qëndrimit/miratimit nga MIE dhe për t’i dhënë kohë shoqërisë “Drini Bulqize” sh.p.k. për të plotësuar dokumentacionin e munguar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 161, datë 5.6.2026, u vendos zgjatja deri në 30 (tridhjetë) ditë e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me transferimin e plotë të licencës nga shoqëria “Drini Bulqize” sh.p.k. te shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.

- Me shkresat nr. 1005/11 prot., datë 10.6.2026, nr. 1005/12 prot., datë 11.6.2026, nr. 1005/14 prot., datë 25.6.2026, nr. 1005/15 prot., datë 26.6.2026 dhe *email-in* nr. 1005/16 prot., datë 29.6.2026, shoqëria depozitoi dokumentacion shtesë, përfshirë korrespondencën me AMBU-në dhe formularin e aplikimit për transferimin e lejes për përdorimin e burimit ujor.

- Duke qenë se qëndrimi i MIE-s nuk ishte administruar ende, me vendimin nr. 181, datë 6.7.2026, Bordi i ERE-s vendosi pezullimin e afatit të vendimmarrjes deri në administrimin e qëndrimit të MIE-s dhe plotësimin e dokumentacionit, vendimmarrje për të cilën u njoftuan shoqëria me shkresën nr. 1005/18 prot., datë 15.7.2026 dhe MIE me shkresën nr. 1005/19 prot., datë 15.7.2026.

- Me *email-in* e protokolluar në ERE me nr. 1005/20 prot., datë 31.7.2026, si dhe me shkresat nr. 1005/21 prot., datë 3.8.2026 dhe nr. 2388 prot., datë 3.8.2026, shoqëria depozitoi dokumentacionin plotësues, përfshirë shkresën e MIE-s nr. 2712/4 prot., datë 31.7.2026, drejtuar shoqërisë “HEC Polemi” sh.p.k. dhe shoqërisë “Drini Bulqize” sh.p.k., nëpërmjet të cilës MIE ka miratuar transferimin e të drejtës për ndërtimin e HEC “Polemi”, me kusht që të mbarten të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë kontratë, në të



kundërt ky miratim është i pavlefshëm. Po ashtu, në këtë shkresë përcaktohet se palët duhet të paraqiten pranë MIE-s, për të reflektuar ndryshimet përkatëse në kontratë.

- Me depozitimin e shkresës së MIE-së nr. 2712/4 prot., datë 31.7.2026, rezulton se është përmbushur kërkesa për marrjen e miratimit të autoritetit kontraktor për transferimin e së drejtës së ndërtimit. Reflektimi i ndryshimeve në kontratë lidhet me përditësimin e marrëdhënies kontraktore ndërmjet palëve dhe nuk pengon vijimin e procedurës administrative, ndaj vlerësohet që t'i lihet kusht shoqërisë për të depozituar amendimin e kontratës nr. 119 rep, nr. 61/1 kol., datë 24.1.2028 sapo kjo të nënshkruhet me MIE-n.

- Me administrimin e qëndrimit të MIE-s dhe dokumentacionit plotësues të aplikimit rezulton se janë plotësuar shkaqet që çuan në pezullimin e procedurës administrative, ndaj vlerësohet heqja e pezullimit dhe vijimi i shqyrtimit të kërkesës.

- Nga sa administruar në kuadër të këtij aplikimi, rezulton se Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), me shkresën nr. 934/1 prot., datë 12.6.2026, ka orientuar shoqërinë se duhet të bëjë aplikimin për transferimin e lejes për përdorim burimi ujqor dhe të mbajë në konsideratë që të kryejë reflektimet përkatëse në kontratën e nënshkruar me MIE-n. Shoqëria ka dokumentuar kryerjen e këtij aplikimi.

- Për sa më lart, duke qenë se miratimi i AMBU-së përbën një dokument të rëndësishëm në kuadër të kalimit të të drejtave dhe detyrimeve për operimin e HEC "Polemi", vlerësohet që ERE të miratojë transferimin e plotë të licencës, duke përcaktuar si kusht për hyrjen në fuqi të tij depozitimin e miratimit të AMBU-së për transferimin e së drejtës së përdorimit të burimit ujqor për prodhimin e hidroenergjisë.

- Duke qenë se miratimi i MIE-së është administruar, ndërsa shoqëria ka iniciuar procedurën pranë AMBU-së për transferimin e lejes për përdorimin e burimit ujqor, vlerësohet që transferimi i licencës të miratohet, duke përcaktuar si kusht për hyrjen në fuqi të tij depozitimin në ERE të miratimit të AMBU-së për transferimin e së drejtës së përdorimit të burimit ujqor.

Përputhshmëria e aplikimit me rregulloren

- Në përputhje me nenin 17, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar

për modifikimin e licencës sipas germave "a", "b", "c", "d" dhe "f".

- Rezulton se shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar. Po ashtu, rezulton se shoqëria ka shlyer dhe pagesat e rregullimit ndaj ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të heqë pezullimin e vendosur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181, datë 6.7.2026 "Mbi pezullimin e procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë 'Drini Bulqize' sh.p.k. për transferimin e plotë të licencës së prodhimit të energjisë elektrike te shoqëria "HEC Polemi" sh.p.k.

2. Të miratojë transferimin e licencës me nr. 577, seria P24, dhënë shoqërisë "Drini Bulqizë" sh.p.k. me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 29.4.2024, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC "Polemi", me kapacitet të instaluar 1.751 mw, te shoqëria "HEC Polemi" sh.p.k.

3. Ky miratim hyn në fuqi me depozitimin në ERE të miratimit përkatës nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) për transferimin e të drejtës së përdorimit të burimit ujqor për prodhimin hidroenergjie.

4. Shoqëria "HEC Polemi" sh.p.k. të depozitojë në ERE amendimin e kontratës nr. 119 rep., nr. 61/1 kol., datë 24.1.2018, menjëherë pas nënshkrimit të saj me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE).

5. Ky vendim është objekt rishikimi në varësi të depozitimit të dokumentacionit të përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të këtij vendimi, si dhe në rast të depozitimit të dokumenteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për këtë vendimarrje.

6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës të njoftojë shoqërinë "Drini Bulqize" sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), OSSH sh.a., FTL sh.a. dhe ALPEX sh.a., për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 228, datë 10.8.2026

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “DRINI BULQIZË” SHPK PËR MARRJEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR TRANSFERIMIN E ASETVE FIKSE TË HEC “POLEMIT”, NGA SHOQËRIA “DRINI BULQIZË” SHPK TEK SHOQËRIA “HEC POLEMI” SHPK

Në mbështetje të neneve 16, 20, germa “a”, 46, pika 1 dhe 136, pika 2, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 4, germa “b”, nenit 6, 7 dhe 8 të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 119, datë 21.7.2016; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; si dhe pikës 1.3 dhe pikës 1.6 të “Kushteve të licencës për prodhimin e energjisë elektrike” miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 99, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.8.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1005/23 prot., datë 6.8.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Originës “Mbi kërkesën e shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të HEC “POLEMIT”, nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. te shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k.,

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë “Drini Bulqizë” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 577, seria P24, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 77, datë 29.4.2024, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC “Polemi”, me kapacitet të instaluar 1.751 Mw, me vendndodhje në pellgun ujëmbledhës mbi tre degëzimet e përroit të Neshtës, degë e Zallit të Kostenjës, Bashkia Librazhd, qarku Elbasan, për një afat 30-vjeçar.

- Në vijim të aplikimit të depozituar nga ana e saj me shkresën nr. 1005 prot., datë 30.3.2026, dhe dokumentacionit plotësues të përcjellë me shkresën nr. 1005/1 prot., datë 7.4.2026, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 117, datë 24.4.2026, vendosi fillimin e procedurës lidhur me kërkesën e shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse të HEC “Polemi”, nga shoqëria “Drini Bulqizë” sh.p.k. tek shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k..

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- Me shkresën nr. 1005/4 prot., datë 7.5.2026, ERE ka njoftuar MIE-n për vendimmarrjen si më sipër, duke i kërkuar asaj që të bëjë me dije nëse nga ana e saj ka një qëndrim ndryshe në lidhje me transferimin e aseteve paluajtshme të shoqërisë.

- Me shkresën nr. 1005/7 prot., datë 28.5.2026, MIE njoftoi se kërkesa e shoqërisë për miratimin e ristrukturimit organizativ apo transferimin e aktivitetit ishte ende në fazë shqyrtimi nga ana e saj. Me shkresën nr. 1005/9 prot., datë 4.6.2026, ERE i kërkoj MIE-s depozitimin e qëndrimit përfundimtar.

- Nga korrespondenca e zhvilluar me shoqërinë, rezultoi se kishte ende dokumentacion që nevojitet të plotësohej nga aplikimi, ndaj ERE vlerësoi t'i drejtohej shoqërisë me shkresën nr. 1005/10 prot., datë 4.6.2026.

- Për sa më sipër dhe me qëllim marrjen e qëndrimit/miratimit nga MIE dhe për t'i dhënë kohë shoqërisë “Drini Bulqizë” sh.p.k. për të plotësuar dokumentacionin e munguar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 161, datë 5.6.2026, u vendos zgjatja deri në 30 (tridhjetë) ditë e afatit të vendimmarrjes së Bordit të ERE-s në lidhje me



transferimin e aseteve paluajtshme të HEC “Polemi”, nga shoqëria “Drini Bulqize” sh.p.k. tek shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k..

- Me shkresat nr. 1005/11 prot., datë 10.6.2026, nr. 1005/12 prot., datë 11.6.2026, nr. 1005/14 prot., datë 25.6.2026, nr. 1005/15 prot., datë 26.6.2026 dhe *email*-in nr. 1005/16 prot., datë 29.6.2026, shoqëria depozitoi dokumentacion shtesë, nga i cili nuk rezultonte të ishte depozituar përgjigja/qëndrimi i MIE-s, në lidhje me kërkesën e bërë nga shoqëria, sikurse më sipër cituar.

- Duke qenë se qëndrimi i MIE-s nuk ishte administruar ende, me vendimin nr. 181, datë 6.7.2026, Bordi i ERE-s vendosi pezullimin e afatit të vendimarrjes deri në administrimin e qëndrimit të MIE-s, vendimarrje për të cilën u njoftuan shoqëria me shkresën nr. 1005/18 prot., datë 15.7.2026 dhe MIE me shkresën nr. 1005/19 prot., datë 15.7.2026.

- Me *email*-in e protokolluar në ERE me nr. 1005/20 prot., datë 31.7.2026, si dhe me shkresat nr. 1005/21 prot., datë 3.8.2026 dhe nr. 2388 prot., datë 3.8.2026, shoqëria depozitoi dokumentacionin plotësues, përfshirë shkresën e MIE-s nr. 2712/4 prot., datë 31.7.2026, drejtuar shoqërisë “HEC Polemi” sh.p.k. dhe shoqërisë “Drini Bulqize” sh.p.k., nëpërmjet të cilës MIE ka miratuar transferimin e të drejtës për ndërtimin e HEC “Polemi”, me kusht që të mbarten të gjitha të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë kontratë, në të kundërt ky miratim është i pavlefshëm. Po ashtu, në këtë shkresë përcaktohet se palët duhet të paraqiten pranë MIE-s, për të reflektuar ndryshimet përkatëse në kontratë.

3. Dorëzimi i dokumentacionit plotësues

- Me depozitimin e shkresës së MIE-së nr. 2712/4 prot., datë 31.7.2026, rezulton se është përmbushur kërkesa për marrjen e miratimit të autoritetit kontraktor për transferimin e së drejtës së ndërtimit. Me administrimin e qëndrimit të MIE-s rezulton se janë plotësuar shkaqet që çuan në pezullimin e procedurës administrative, ndaj vlerësohet heqja e pezullimit dhe vijimi i shqyrtimit të kërkesës së transferimit e aseteve të paluajtshme të HEC “Polemi”.

4. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënien e autorizimit

- Nga analiza përfundimtare e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “Drini Bulqize” sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni në

përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 4, 6, 7 dhe 8 të Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, si vijon:

- Neni 4, germa “g” – Për HEC-et me fuqi të instaluar më të vogël se 5 mw, kërkohet miratimi i ERE nëse vlera e aseteve që transferohen është më e madhe se 50.000.000 lekë (pesëdhjetë milionë).

5. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 7:

- **Pika 1** – Janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi kërkesën për transferim, ndër të tjera si më poshtë vijon:

- germa “a” – Është depozituar Ekstrakti historik i shoqërisë, i vlefshëm brenda afatit ligjor;

- germa “b” – Është plotësuar informacioni mbi veprimtarinë e licencuar;

- germa “c” – Është plotësuar informacioni mbi gjendjen financiare të kompanisë në kohën që paraqet kërkesën dhe efekti i pritshëm pas miratimit të transferimit të aseteve;

- germa “d” – Është bërë një përshkrim i kandidatit;

- gjerat “e” “f” dhe “g” – Arsytet e kërkesës, efektet në aktivitetin e licencuar dhe furnizimin e klientëve;

- germa “h” – Është depozituar sa më poshtë;

- Kontratë transferimi pasurie në kuadër të ristrukturimit me ndarje të pjesshme me nr. 2042 rep., nr. 643 kol., datë 16.4.2026, nënshkruar nga palët, ku përcaktohen pasuritë që transferohen, transferim që përfshin por nuk kufizohet në asetet fikse, si impianti i HEC-it Polem të ndërtuar, pajisje mekanike dhe elektrike të instaluar në ndërtesë dhe ndërtesat e infrastruktura përkatëse, linja e tensionit të lartë që shërben për transmetimin e energjisë elektrike deri në n/stacionin Librazhd, linjë interneti.

- germa “i” – Deklarata e kredithënësit për garantimin e vazhdimësisë së aktivitetit;

- germa “j” – Deklarata dhe vërtetimi për mungesë transferimesh të mëparshme mbi asetet fikse.

- Pika 3 – Është plotësuar informacioni i kërkuar në këtë pikë që lidhet me detyrimet me të cilat ngarkohet subjekti për shkak të marrëveshjes së koncesionit në pjesët që transferojnë tek përfituesi përfshirë edhe informimin e Autoriteti Shtetëror, në lidhje me qëllimin e transferimit të aseteve.

- Pika 4 – Kërkesa për aplikim është nënshkruar nga administratori i shoqërisë, ndërsa dokumentet e



tjera shoqëruese të këtij aplikimi janë nënshkruar nga administratori dhe/ose personat e autorizuar sipas rastit.

- Pika 6 – Shoqëria ka bërë me dije se dokumentacioni i dorëzuar është pjesë e aktivitetit të Projektit HEC “Polemi”, i cili është në prodhim, një pjesë e dokumenteve janë të depozituara në institucionet përkatëse nga ku mund të merren informacione të klasifikuara, publiku i interesuar mund ti drejtohet këtyre institucioneve nëse kërkon informacion të konkretizuar.

Në lidhje me sa kërkuar nga ana e shoqërisë, në kuadër të trajtimit me konfidencialitet të dokumentacionit depozituar në kuadër të këtij aplikimi, janë bërë vlerësimet përkatëse nga ana jonë konform ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, si dhe “Rregullores për mbrojtjen e informacionit konfidencial”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 65, datë 26.3.2018, ku është klasifikuar dokumentacioni i cili konsiston në trajtim tërësisht konfidencial apo dokumentacion i cili ka identifikimet përkatëse si konfidenciale, duke zbatuar parimin e kufizimit proporcional (pra, klasifikim vetëm për ato pjesë ku ka bazë ligjore dhe nevojë reale për mbrojtje).

Nga analizimi i dokumentacionit të depozituar, do të konsiderohet konfidencial dokumentacioni, sa më poshtë vijon:

- Shkresat e shoqërisë “Drini Bulqize” sh.p.k. në lidhje me aplikimin për transferimin e aseteve, nr. 1005/1 prot., datë 7.4.2026, shkresën nr. 1005/6 prot., datë 12.5.2026, shkesat nr. 1005/11 prot., datë 10.6.2026 dhe nr. 1005/12 prot., datë 11.6.2026 (këto dokumente do të konsiderohen si konfidencial për arsye se përmbajnë informacione të aktivitetit tregtar të shoqërisë).

- “Kontratë Transferimi Pasurie në kuadër të ristrukturimit me ndarje të pjesshme” nr. 2042 rep., nr. 643 kol., datë 16.4.2026 dhe Raportet e ekspertit kontabël të regjistruar për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë “Drini Bulqize” sh.p.k. dhe “HEC Polemi” sh.p.k. (Këto dokumente do të konsiderohen si konfidencial për arsye se përmbajnë të dhëna me natyrë ekonomike /kontraktuale që mund të dëmtojnë interesat e subjektit/palëve të treta nëse publikohen, si dhe informacione të aktivitetit tregtar të shoqërisë).

Nga ana tjetër, do të konsiderohet dhe trajtohet si jokonfidencial, për arsye se janë dokumente me

karakter deklarativ/informues dhe/ose është e depozituar apo e aksesueshme pranë institucioneve publike kompetente, dokumentacioni si vijon:

- Ekstrakti historik të regjistrit tregtar të shoqërisë “Drini Bulqize” sh.p.k. (ky dokument do të konsiderohet si jokonfidencial, në rrethanat që është i publikuar dhe i aksesueshëm pranë institucioneve publike kompetente);

- Shkresa e shoqërisë drejtuar MIE-s datë 30.3.2026 (ky dokument do të konsiderohet si jokonfidencial, pasi konsiderohen akte deklarative dhe nuk përmbajnë në vetvete sekret tregtar apo informacion financiar të ndjeshëm).

6. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve të paluajtshme të HEC “Polemi”, nga shoqëria “Drini Bulqize” sh.p.k. te shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k., nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet ose miratimet e nevojshme nga organet e tjera kompetente apo nga palët e treta përkatëse, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të heqë pezullimin e vendosur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 181, datë 6.7.2026 “Mbi pezullimin e afatit të vendimmarrjes për shqyrtimin e kërkesës për dhënien e autorizimit për transferimin e aseteve të paluajtshme të HEC ‘Polemi’, nga shoqëria ‘Drini Bulqize’ sh.p.k. tek shoqëria ‘HEC Polemi’ sh.p.k.”, deri në plotësimin e kushteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi.

2. Të miratojë kërkesën e shoqërisë “Drini Bulqize” sh.p.k. për marrjen e autorizimit nga ERE për transferimin e aseteve fikse tek shoqëria “HEC Polemi” sh.p.k. (për kontratën nr. 2042 rep., nr. 643 kol., datë 16.4.2026). Bashkëlidhur lista e aseteve fikse që transferohen.

3. Dhënia e autorizimit sipas përcaktimeve të pikës 2 nuk e çliron shoqërinë “Drini Bulqize” sh.p.k. nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

4. Ky vendim është objekt rishikimi në rast se depozitohet ndonjë dokument i ndryshëm nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.



5. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “Drini Bulqize” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

“ASETET E PALUAJTSHME TË HEC POLEMI QË DO TË TRANSFEROHEN NGA SHOQËRIA “DRINI BULQIZË” SHPK TEK SHOQËRIA “HEC POLEMI” SHPK”

§ Ndërtesa dhe infrastruktura përkatëse (AAGJM materiale dhe në proces) për HEC POLEM, me vlerë 424,397,935 lekë;

§ Të tjera instalime (pajisjet mekanike dhe elektrike të instauara në ndërtesë) dhe pajisje të HEC POLEM, me vlerë 76,616,337 lekë;

Vlera totale rezulton 501,014,272 (pesëqind e një milionë e katërmëdhjetë mijë e dyqind e shtatëdhjetë e dy) lekë.”

VENDIM

Nr. 229, datë 10.8.2026

MBI DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT KRYESOR QË KONTROLLON INTERESAT E SHOQËRISË “NOA ENERGY TRADE” SHPK

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 5, 7, 9, pika 4 dhe 5, dhe nenit 10, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e

kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.8.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2080/3 prot., datë 5.8.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Noa Energy Trade’ sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor që kontrollon interesat e të licencuarit”,

konstatoi se:

Për qëllime të shqyrtimit të kërkesës për dhënien e autorizimit për shoqërinë “Noa Energy Trade” sh.p.k., është ndjekur procedura dhe është analizuar dokumentacioni si vijon:

1. Kërkesa për marrjen e autorizimit

- Shoqëria “Noa Energy Trade” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 7, datë 2.2.2015, të ndryshuar dhe në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 243, datë 2.12.2021.

- Me shkresën nr. 2080 prot., datë 9.7.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesë dhe dokumentacion në lidhje me marrjen e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit.

2. Shqyrtimi i kërkesës dhe kërkesa për dokumentacion plotësues

- ERE me shkresën nr. 2080/1 prot., datë 20.7.2026 dhe email-in e datës 27.7.2026, i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin e munguar në këtë aplikim.

- Shoqëria me shkresën nr. 2080/2 prot., datë 3.8.2026, depozitoi sa kërkuar.

3. Përfundime dhe kërkesa të tjera për dhënien e autorizimit

- Nga analiza përfundimtare e dokumentacionit të përcjellë nga shoqëria “Noa Energy Trade” sh.p.k., rezulton se është dorëzuar dokumentacioni në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenet 5 dhe 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e



ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 235, datë 26.11.2022, si vijon:

- Neni 5, pika 2 – Kërkesa dhe dokumentet shoqëruese janë nënshkruar nga administratori i shoqërisë.

4. Plotësimi i kërkesave të nenit 5:

- Neni 5, pika 4 – Dokumentacioni është paraqitur në gjuhën shqipe, në format origjinal ose të noterizuar dhe i shoqëruar me kopje elektronike.

- Neni 5, pika 5 – Shoqëria ka bërë me dije se kërkon të mos bëhet publike Marrëveshja e Transferimit të Kuotave, pasi kjo marrëveshje përmban të dhëna lidhur me çmimin e shitjes dhe kushte e klauzola të tjera kontraktore që lidhen me këtë transferim. Këto të dhëna nuk kanë lidhje të drejtpërdrejtë me transparencën e procesit të kalimit të pronësisë, për sa kohë që të dhënat lidhur me personin që ka transferuar kuotat dhe subjektin që i ka fituar, janë të regjistruara dhe të aksesueshme në QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Për sa kërkuar nga shoqëria, sqarojmë se në nenin 44, pika 1, të ligjit nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, parashikohet si vijon:

1. “E drejta për mbrojtjen e të dhënave personale ushtrohet në harmoni me të drejtën e aksesit në dokumentet zyrtare dhe të drejtën e informimit, siç parashikohet në ligjin nr. 45/2022, “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për aksesin në dokumentet zyrtare”, ligjin nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, si dhe ligjin nr. 33/2022, “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.

Në reference të përcaktimeve të nenit më sipër, i cili kërkon balancimin e mbrojtjes së të dhënave personale me të drejtën e informimit, si dhe me nenin 17, të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit”, sipas të cilit kufizimi i së drejtës së informimit lejohet vetëm në masën e nevojshme dhe proporcionale për mbrojtjen e interesave të ligjshëm, rezulton se kur një dokument përmban njëkohësisht informacion publik dhe të dhëna personale, autoriteti publik duhet të kufizojë aksesin vetëm ndaj pjesës që përmban të dhëna personale, nëpërmjet anonimizimit ose fshirjes së tyre, ndërsa

pjesa tjetër e dokumentit, e cila nuk përmban të dhëna personale apo informacione të tjera të mbrojtura me ligj, mbetet e aksesueshme dhe duhet t’i vihet në dispozicion kërkuar. Për sa më sipër, vlerësohet se në “Marrëveshjen për transferimin e kuotave”, datë 5.4.2023 të dhëna apo informacion që duhet të trajtohen me konfidencialitet janë vetëm të dhënat personale të z. Sula dhe të dhënat financiare (çmimin e shitjes së kuotës).

5. Plotësimi i kërkesës sipas nenit 7:

- Pika 1 - Janë paraqitur të gjitha të dhënat e kërkuara mbi shoqërinë, përfaqësuesin e autorizuar, arsyet mbi ndryshimin e ortakut/aksionarit aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit, efektin e pritshëm pas miratimit të transferimit dhe ndikimin e transferimit në ushtrimin e aktivitetit të licencuar, një përshkrim të kandidatit të propozuar, informacion mbi kontributin financiar që do të japë.

- Pika 2 - Janë dorëzuar të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë ekstraktin historik të regjistrit tregtar, vendimet e organeve drejtuese, marrëveshjen përkatëse dhe dokumentacionin tjetër shtetëror si më poshtë vijon:

- germa “a” - Ekstrakti historik i regjistrit tregtar.

- germa “c” - Vendimi i organeve drejtuese: Është depozituar Vendimi i Ortakut të vetëm të shoqërisë “Noa Energy Trade” sh.p.k., datë 5.4.2023, nëpërmjet të cilit është miratuar transferimi i kuotës.

- germa “d” - Marrëveshjet paraprake përkatëse:

- “Marrëveshje për transferimin e kuotave”, datë 5.4.2023, nënshkruar midis palëve, me anë të së cilës është dakordësuar transferimi i kuotës nga z. G. S., tek shoqëria “Noa Holding” sh.p.k..

- Pika 3 - Shoqëria ka shlyer të gjitha detyrimet financiare ndaj ERE-s.

6. Kushtet e vendosura për dhënien e autorizimit

- Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Noa Energy Trade” sh.p.k., nuk e përjashton këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimet/miratimet e nevojshme nga palë të treta, në rast se kërkohet prej tyre.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 9, pika 8 të rregullores nr. 235/2021, ku citohet se shoqëria duhet të depozitojë në ERE ekstraktin historik të regjistrit tregtar të QKB-së të përditësuar ku të jetë reflektuar ndryshimi i ortakut, vlen të sqarojmë se shoqëria e ka një veprim tashmë të ezauruar/



pasqyruar, si e tillë nuk lind e nevojshme të mbahet në konsiderate në vijim, gjithmonë në rastin e dhënies së autorizimit nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut kryesor që kontrollon interesat e shoqërisë “Noa Energy Trade” sh.p.k., nga ortaku i mëparshëm z. G. S., tashmë sipas strukturës së kërkuar, për 100% të kuotave të kapitalit tek shoqëria “Noa Holding” sh.p.k. (sipas marrëveshjes për transferimin e kuotave datë 5.4.2023).

2. Dhënia e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Noa Energy Trade” sh.p.k., nuk e çliron këtë të fundit nga detyrimi për të marrë autorizimin/miratimin e organeve të tjera apo palëve të treta për këtë ndryshim, në rast se kjo kërkohet nga këto organe.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Noa Energy Trade” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrît Ahmeti



	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë



[[FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË][Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare][Viti: 2026 - Numri: 183][Datë: 21.08.2026 12:03:25 +02:00][f43176e5-476b-48b8-8057-503f72d8ec0a]

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik(Qendra e Botimeve Zyrtare)